

USHTRIM¹

(përmbledhje e hapave që ndërmerren në përcaktimin e normës së rregulluar)

Në vijim është paraqitur një bilanc i thjeshtësuar i gjendjes së një kompanie që ofron shërbime publike. Të gjitha shumat janë të shprehura në (mijëra) dollarë amerikanë.

Asetet	('000 USD)	Obligimet	('000 USD)
Asetet aktuale	25,400	Obligimet aktuale	16,300
Të holla të gatshme dhe ekuivalenti i tyre	5,600	Llogaritë e pagueshme	5,400
Llogaritë e pranueshme	9,800	Tatimet e ndryshueshme	3,800
Inventari	6,300	Huamarrjet afatshkurta	7,100
Të tjera	3,700		173,100
Asetet fikse	320,000	Borxhet afatgjata	173,100
Rrjeti dhe makineria	400,000	Kapitali aksionar	156,000
Amortizimi i akumuluar	-80,000	Aksionet e përbashkëta	86,000
		Fitimet e nxjerra	70,000
Total Asete	345,400	Total Obligime	345,400

Bilanci i gjendjes së një kompanie hipotetike të distribucionit, shprehur në mijëra dollarë (31 dhjetor 2006)

Pjesa fikse e shpenzimeve operative dhe të mirëmbajtjes arrin shumën prej 24.5 milionë dollarë, përfshirë shpenzimet për personel, koston e mirëmbajtjes së rrjetit, tatimet jo në të ardhura dhe pagesat për punëtorë.

Kjo kompani mund të blejë energjinë elektrike me çmim mesatar me shumicë prej 30 USD/MWh dhe t'ia bartë atë konsumatorëve me të njëjtin çmim. Humbjet në rrjetin e distribuimit, mesatarisht, përbëjnë rreth 9.5% të energjisë që hyn në rrjet.

Jetëzgjatja e parashikuar e elementeve dhe makinerisë së rrjetit është 20 vite, me vlerë neto të mbetur zero. Politika aktuale e amortizimit (e miratuar nga rregullatori) është lineare (për tërë jetëzgjatjen) dhe korrespondon me jetëzgjatjen e paraparë të shërbimit.

Rregullatori shfrytëzon WACC para tatimit, siç justifikohet në normën e fitimit. Norma pa rrezik është 6 %, CAPM Beta është 0,5, premiumi i rrezikut të tregut është 4 % (pas taksave). Norma e fitimit në huazime është 8 %. Taksa e korporatës është 16%. Struktura e kapitalit është e paraqitur në bilanc të gjendjes.

Kompania parasheh kërkesë prej 10 TWh energji elektrike në vitin e ardhshëm (që për shkaqe thjeshtësimi do të supozojmë se nuk do të varet nga çmimi).

1.1. Kalkuloni bazën e normës (kapitali punues është gjithashtu pjesë e bazës së normës).

¹ Based on ERRA Training exercise worked out by experts of Regional Centre for Energy Policy

Ndihmesë: kapitali punues i referohet dallimit mes asetëve aktuale dhe obligimeve aktuale

1.2. Kalkuloni WACC para taksave.

1.3. Kalkuloni kërkesën për të ardhura.

1.4. Kalkuloni çmimin e shërbimit të distribuimit të energjisë elektrike në këtë fushë.

Ndihmesë: Ju e dini normën e kthimit dhe shumën e energjisë së furnizuar.

1.5. Çfarë do të ishte pozita financiare e kompanisë së shërbimeve publike, nëse arrin të zvogëlojë humbjet në 8% (të energjisë që hyn në rrjet). Të gjitha kushtet tjera mbasin të pandryshueshme.

1.6. Çfarë do të ishte pozita financiare e kompanisë së shërbimeve publike nëse kërkesa reale (konsumi final) do të ishte 11 TWh në vend të 10 TWh? Të gjitha kushtet tjera mbasin të pandryshueshme

1.7. Çfarë do të ishte pozita financiare e kompanisë së shërbimeve publike nëse çmimi mesatar i shitjes me shumicë rritet në 32 USD/MWh (në vend të 30 USD/MWh) dhe nëse nuk ka mundësi që të rriten çmimet e shitjes me pakicë? Të gjitha kushtet tjera mbasin të pandryshueshme

1.8. Për shkak të një rregulloreje të re 5% e konsumit final duhet të blihen nga gjeneratorët që prodhojnë energji nga burime të ripërtëritshme të energjisë (RES-E). Sa do të jetë çmimi vetëm për distribuimin e energjisë elektrike, nëse tarifa uniforme e hyrjes për RES-E është 50 USD/MWh (kostoja e energjisë është element kalimtar, nuk bartë profit as humbje)?